



KËSHILLI DREJTUES

V E N D I M

Nr. 32, datë 18.12.2018

Për miratimin e një shtese në Vendimin e Këshillit Drejtues nr. 5, datë 30.03.2017 “Mbi miratimin e rregullores për administrimin e aktiveve në Agjencinë e Sigurimit të Depozitave”

Në mbështetje dhe për zbatim të nenit 43, pika 1, shkronja “m” dhe të nenit 52, pika 1, shkronja “dh” të Ligjit nr. 53/2014, datë 22.05.2014 “Për sigurimin e depozitave” i ndryshuar, me propozim të Drejtorit të Përgjithshëm, Këshilli Drejtues

V E N D O S I:

1. Në Rregulloren “Për administrimin e aktiveve në Agjencinë e Sigurimit të Depozitave”, bashkëlidhur vendimit të Këshillit Drejtues nr. 5, datë 30.03.2017, pas pikës 2 të nenit 10, shtohet pika 2/1 me përmbajtjen si vijon:

“2/1 Jeta e dobishme e aktiveve afatgjata materiale dhe jo materiale rivlerësohet në fund të çdo viti financiar. Rishikimi i jetës të dobishme të aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale bëhet me vendim të Këshillit Drejtues me propozim të njësive organizative përgjegjëse të Agjencisë. Nëse jeta e dobishme e pritshme e aktivitetit ndryshon nga vlerësimet e mëparshme, periudha e amortizimit ndryshon përkatësisht.”

2. Ngarkohen të gjitha njësitë organizative të Agjencisë për zbatimin e këtij vendimi.
3. Ngarkohet Sektori i Marrëdhënieve me Publikun për publikimin e këtij vendimi në faqen zyrtare të internetit të Agjencisë.


Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KËSHILLI DREJTUES

Martin Blushi

Donald Duraj

REPUBLIKA E SHQIPËRISË



AGJENCIA
E SIGURIMIT
TË DEPOZITAVE

Agjencia e Sigurimit të Depozitave
Rruga e Elbasanit, Nr. 317
Tiranë/Albania

t: +355 (4) 2362 989/2347 298

f: +355 (4) 2362 984

e: info@asd.gov.al

www.asd.gov.al

KËSHILLI DREJTUES

Sekretar

Kryetar